



Save the Children




Roli i ekipit në hartimin dhe zbatimin e Planeve Edukative Individuale (PEI), në kopshte e shkolla



Ekipi që harton dhe zbaton PEI brenda shkollës/kopshtit, përfaqëson një bashkëveprim midis profesionistëve dhe prindit, në procesin e arsimimit të fëmijës me aftësi të kufizuara ose vështirësi në të nxënë.

Ekipi që harton dhe zbaton PEI ka për qëllim të hartojë një program të personalizuar, i cilësuar si Plani Edukativ Individual, që bazohet në vlerësimin e aftësive që ka fëmija me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë, si edhe në vlerësimin e nevojave arsimore dhe zhvillimore të tij. Hartimi i PEI synon realizimin e të drejtës për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës të çdo fëmije, brenda shkollës dhe kopshtit ku janë edhe bashkëmoshatarët.



Ekipi i hartimit dhe zbatimit të PEI **në shkollë /kopsht përbëhet nga :**

1. Një anëtar i drejtorisë së shkollës (drejtor/ nëndrejtor)
2. Punonjësi i shërbimit psikologjik në shkollë (psikologu ose punonjësi social i shkollës)
3. Mësuesi i klasës (kur fëmija ndjek ciklin fillor, kl.1-5)
4. Mësuesit e lëndëve në të cilat fëmija me aftësi të kufizuara ose vështirësi në të nxënë, shfaq nevojë për mbështetje të veçantë (kur fëmija ndjek ciklin e ulët të mesëm në klasat 6-9).
5. Mësuesi ndihmës (nëse shkolla ka të tillë)
6. Prindi i fëmijës.

Në përbërje të këtij ekipi mund të jenë dhe punonjës të tjerë të arsimit apo specialistë zhvillimi që kanë përvoja pozitive në punën me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë.

Funksioni i ekipit që harton dhe zbaton PEI në **shkollë / kopsht:**

- Ekipi i PEI ndërton Planin Edukativ Individual për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore bazuar në raportin e vlerësimit të fëmijës të përgatitur nga komisioni i vlerësimit në DAR, si dhe në udhëzimin e dërguar në shkollë/kopsht nga ky komision.
- Grupi i PEI harton programin që do të ndjekë fëmija në shkollë/kopsht, duke përcaktuar objektivat, kohën, personelin dhe materialet didaktike të nevojshme për realizimin e këtyre objektivave.
- Ekipi fillon aktivitetin e tij pasi ka arritur të sigurojë bashkëpunimin dhe aprovimin e prindit të fëmijës për të ndërtuar një PEI.
- Ekipi përcakton rregullat dhe normat e funksionimit të grupit dhe funksionon mbi bazën e këtyre rregullave e normave.
- Për çdo fëmijë me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë, ekipi i PEI mblidhet jo më pak se tre herë në vit për: (1) hartimin e objektivave në PEI, (2) vlerësimin e arritjeve të fëmijës përkundrejt PEI me qëllim rishikimin e objektivave të tij dhe (3) rishikimin e PEI duke përshtatur objektivat e tij, bazuar tek arritjet e vlerësuara të fëmijës, deri në momentin e takimit të radhës.
- Drejtoria e kopshtit shkollës në bashkëpunim me

punonjës in e shërbimit psiko- social të shkollës/kopshtit, marrin masa që prindi i fëmijës të jetë i pranishëm dhe të bashkëpunojë në mënyrë aktive në të gjitha takimet që grupi zhvillon për të vlerësuar situatën arsimore të fëmijëve dhe për të ndërtuar PEI për secilin fëmijë. Ekipi i PEI kujdeset për të respektuar çështjet etike, ato të konfidencialitetit të të dhënave të fëmijës dhe familjes së tij, si dhe të drejtat e fëmijës brenda shkollës/kopshtit.

- Ky ekip, mund t'i sugjerojë prindit vlerësime të tjera më të specializuara për fëmijën, në institucione apo nga ekipe që funksionojnë jashtë shkollës/kopshtit, në varësi të nevojave dhe kërkesave që paraqet fëmija.

Rolet dhe përgjegjësitë e antarëve të ekipit të PEI në shkollë/kopsht:

Detyrat e anëtarit të drejtorisë së shkollës/kopshtit

Anëtari i drejtorisë së shkollës/kopshtit:

1. është përgjegjës për ecurinë dhe mbarëvajtjen e ekipit;
2. koordinon veprimtarinë e ekipit
3. përcakton kohën e takimit dhe përbërjen e ekipit;
4. drejton takimet/mbledhjet;
5. monitoron aktivitetin e grupit gjatë vitit shkollor;
6. sugjeron, në bashkëpunim me specialistët e tjerë, ndryshimet e mundshme në metodat e vlerësimit, mënyrat e testimit, si dhe përfshirjen e specialistëve të tjerë brenda dhe jashtë shkollës.
7. përgjigjet për ruajtjen e dokumentacionit/dosjeve me të gjitha të dhënat për fëmijën.

Detyrat e mësuesit të klasës apo të lëndës që do të zbatojë PEI -në

Mësuesi:

- informon ekipin për përparimin e fëmijës në lëndët mësimore, nivelin e pjesëmarrjes në procesin mësimor, mënyrën si ndërvepron me moshatarët në mjediset e klasës/shkollës/kopshtit, mundësitë dhe aftësitë që ka fëmija, si dhe vështirësitë që shfaq fëmija si në përvetësimin e njohurive shkollore dhe në shoqërimin me bashkëmoshatarët;
- mban kontakte me kolegët e tjerë për sa i përket ecurisë së fëmijës në lëndët e tjera;
- dokumenton arritjet dhe vështirësitë e fëmijës përmes shënimeve në një fletore të tij personale, në dokumentacionin shkollor ose në punimet e fëmijës. Shënimet më të rëndësishme, shoqëruar me punimet përkatëse të fëmijës dhe datën kur janë mbajtur, vendosen në dosjen e fëmijës për t'ju referuar sa herë rishikohet PEI;
- sugjeron për diskutim në ekip dhe më pas zbaton në klasë strategjitë konkrete dhe mënyrën e ndërhyrjes për realizimin e objektivave të PEI;
- përcakton mjetet dhe mënyrat e përshtatshme, që do të përdorë për të stimuluar dhe inkurajuar fëmijën;
- beson dhe ka pritshmëri në mundësitë reale të fëmijës për të realizuar objektivat e përcaktuara në PEI.



Detyrat e punonjësit të shërbimit psikologjik:

Punonjësi i shërbimit psikologjik në shkollë/kopsht:

1. sjell informacione mbi situatën psiko-sociale të fëmijës, kontekstin familjar, atmosferën në klasë/shkollë;
2. jep mendime për formulimin e objektivave të PEI dhe këshilla për zbatimin e tyre;
3. kujdeset për ruajtjen e konfidencialitetit, anonimatit



të çdo informacioni që lidhet me fëmijën dhe familjen e tij;

4. jep informacionet që përmban dosja e fëmijës vetëm në rastet kur drejtoria e shkollës/kopshtit apo punonjës të DAR-së aprovojnë me shkrim dhënien e këtyre

informacioneve, bazuar në legjislacionin arsimor përkatës;

5. mban lidhje të vazhdueshme me prindërit për të shkëmbyer me ta çdo informacion rreth fëmijës dhe për fëmijën, ndihmon prindërit për të kuptuar dhe qartësuar më mirë rolet dhe detyrat e tyre në procesin e hartimit të PEI-së;
6. përcjell shqetësimet e prindërve dhe të mësuesëve tek anëtarët e grupit;
7. mban kontakte me punonjësit shkollës/ kopshtit ku shërben, për çdo gjë që lidhet me fëmijën;
8. informon bashkëmoshatarët e fëmijës me aftësi të

kufizuara dhe vështirësi në të nxënë për nevojat që ka shoku i tyre brenda dhe jashtë klasës/grupit, si edhe programin (PEI-n) që ndjek fëmija;

Detyrat e prindit

Prindi i fëmijës me aftësi të kufizuara ose vështirësi në të nxënë:

1. informon ekipin e PEI rreth karakteristikave kryesore të zhvillimit të fëmijës;
2. informon ekipin rreth historikut të aftësisë së kufizuar ose vështirësive në të nxënë dhe kohës kur janë shfaqur këto tek fëmija;
3. Informon për sjelljet dhe qëndrimet e fëmijës brenda dhe jashtë mjedisit familjar;
4. informon për mardhëniet e fëmijës me familjarët;
5. i bën të ditur ekipit pritshmëritë që ka për ecurinë dhe arritjet e fëmijës;
6. informon për mundësitë që ka familja për të mbështetur fëmijën në zbatimin e PEI në kushtet e shtëpisë;
7. merr përsipër të ndihmojë fëmijën në zbatimin e objektivave të PEI në kushtet e shtëpisë, duke qenë i kujdesshëm dhe i vëmendshëm ndaj çdo udhëzimi dhe detyre që mësuesit dhe antarët e grupit japin për zbatimin e objektivave të përcaktuara në PEI;
8. komunikon me mësuesin rregullisht për të bashkërenduar ndihmesën ndaj fëmijës gjatë zbatimit të PEI;
9. është i hapur dhe realist për nevojën që ka për ndihmë ai dhe fëmija e tij.

